

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. L., nga fshati G. Komuna e K. të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Rr. L. nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I. nr. 171/2016, të datës 26.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 21.10.2016, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. L., nga i ati A. dhe nëna V., i lindur më datë ... , në fshatin F. Komuna e K., tani jeton në fshatin G. Komuna e K., i martuar, baba i ... fëmijëve, i pa punë, din shkrim dhe lexim ka të kryer shkollën e mesme gjimnazi i përgjithshëm, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se që nga data2010, i akuzuari në shtëpinë e tij në fsh.F. Komuna e K. , pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armë të zjarrit, ashtu që sipas urdhëresës së Gjykatës UGJK.134/2016 gjatë bastisjes në shtëpinë e tij më datë2016 rreth orës ...h, është gjetur dhe sekuestruar arma e zjarrit – pushkë gjahu e markës “...” me nr. serik ... prodhim turk, e kalibrit ... pa fishekë.

Me çka ka kryer veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41, 42, 51, 53, 69, 73, 114 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK-ës dhe neneve 365, dhe 453 të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

Të akuzuarin S. L., me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, të cilin dënim burgu i akuzuari nuk do ta vuaj nëse në periudhën kohore prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi i kushtëzuar do të revokohet,

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës së zjarrit– pushke gjahu e markës “...” me nr. serik ... prodhim turk, e kalibrit ... pa fishekë.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzet e pesë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I. nr.171/2016 të datës 26.07.2016, kundër të akuzuarit S. L., nga fshati G. Komuna e K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, Agron Uka në deklarinimin e tij shtoi se meqë i akuzuari e ka pranuar veprën penale sa i përket rrethanave që duhet vlerësuar gjatë matjes së dënimit i

propozoi gjykatës që ti merr parasysh si rrethana lehtësuese faktin se i akuzuari në tërësi e ka pranuar veprën penale, se i njëjti është njeri familjar, është baba i pesë fëmijëve është penduar për veprën penale. Ndërsa si rrethana rënduese është evidente edhe atë pesha e veprës penale dhe rrezikshmëria shoqërore e veprës penale.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare S. L., av.Rr. L.deklaroi se i mbrojturi im në tërësi e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës dhe shtoi se është e vërtetë se arma e përmendur është gjetur në shtëpinë e të mbrojturit tim i cili jeton në një fshat malor, për të cilën armë i njëjti ka poseduar leje por me afat të skaduar e cila edhe është trajtuar si leje jo e vlefshme. Prandaj duke pasur parasysh këtë fakt propozoi gjykatës që me rastin e matjes së dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese duke pasur parasysh se i mbrojturi im është njeri familjar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike , kështu që duke pasur parasysh të gjitha këto të akuzuarit ti shqiptoi një dënim të lehtë të kushtëzuar pasi që konsideroi se e njëjta do ta jep efektin e duhur juridik.

I akuzuari S. L., fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe shtoi, premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të këtij lloji, ngase jam njeri familjar dhe mbajtës i familjes, për të njëjtën armë unë kam poseduar leje por që e njëjta ka qenë e skaduar, i gjendjes së varfër ekonomike dhe se jetoj në një fshat malor. Andaj duke e përkrahur në tërësi deklarinë përfundimtare të mbrojtësit tim av.R. L. , kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të but që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e në veçanti vërtetimin mbi konfiskimin e pushkës së gjuetisë të datës2016, procesverbalin mbi bastisjen e banesës dhe personave i datës 12.07.2016, foto dokumentacionit, leja e mbajtjes së armës e cila ka skaduar më datë2010 si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari S. L., në mënyrë të paautorizuar në shkelje të ligjit të zbatueshëm, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit – pushkë gjahu e markës “...” me nr. serik ... prodhim turk, e kalibrit ... pa fishekë dhe e njëjta i është sekuestruar nga ana e policisë, me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1.të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenit 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se është i gjendjes së rëndë

ekonomike, se për këtë armë nuk ka dëshmi se ka pasur leje. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit të veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore duke qenë se posedimi i armës pa leje paraqet rrezik për popullatën, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Të akuzuarit S. L., i është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës së zjarrit– pushke gjahu e markës “...” me nr. serik ... prodhim turk, e kalibrit ... pa fishekë, bazuar në neneve 69 par.1 dhe 374 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 172/2016 Me datë 21.10.2016**

Sek. Juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.*